


NJË STRATEGJI E SUKSESSHME ANTIKANABIS

Nga Dr. Xhavit Shala

Në Shqipëri, deri në vitin 2000, qarku i Fierit zinte vendin kryesor në hartën e kultivimit të bimëve narkotike *kanabis sativa*. Përballja me këtë dukuri kaq masive kriminale ishte një sfidë për mua si drejtor i policisë së këtij qarku në ato vite.

Numri i bimëve narkotike të asgjësuara në qarkun e Fierit krahasuar me ato në shkallë vendi (1998-2000)



Së bashku me stafin që drejtoja, Nëndrejtorin e Policisë Mihal Monka, shefat e Zyrave Rajonale Ritvan Zoto, Ardjan Kumanaku, Zigur Bixha, Specialistin e Marëdhënieve më Publikun Rrapi Vogli e te tjerë, luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike e vlerësuam si një nga sfidat kryesore në luftën kundër krimit dhe vendosëm të përballëshim me të. Pasi analizuam shkaqet e dështimit në vite të luftës ndaj kësaj dukurie, hartuam një strategji të re dhe besuam në suksesin e zbatimit të saj.

Strategjia përfshinte forma dhe metoda të reja lufte kundër kultivimit të kanabisit, të paprovuara më parë nga policia shqiptare. Ajo synonte, fillimisht, parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, si edhe luftën e mëtejshme ndaj kësaj dukurie. Kjo do të realizohej duke bashkëpunuar me komunitetin, me strukturat e pushtetit vendor, me drejtoritë arsimore dhe me organizatat joqeveritare. Strategjia e re u publikua për herë të parë në qarkun e Fierit në fillim të vitit 2001. Si detyra kryesore të saj u përcaktuan:

1. Organizimi i takimeve me komunitetin në çdo lagje e fshat, sidomos në zonat që kishin kultivuar më parë bimë narkotike. Kjo do të realizohej nga grupe të përbëra me përfaqësues të Drejtorisë së Policisë, të prefekturës, të komunave dhe kryepjeqësive, të drejtorive arsimore e deri me përfaqësues të komuniteteve fetare. Takimet synonin zhvillimin e një pune për ndërgjegjësimin e banorëve për përgjegjësitë ligjore që kishin, nëse kultivonin kanabis. Në këto takime jepej mesazhi i qartë dhe i prerë se nuk do të tolerohej asnjë rast apo përpjekje për kultivimin e bimëve narkotike.

** Kultivuesit, tashmë, “kishin mbi kurriz” jo vetëm policinë, por edhe strukturat e tjera shtetërore dhe pushtetin vendor. Përfshirja e shumë strukturave për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike e shndërroi luftën ndaj kësaj dukurie në një problem të të gjithë shoqërisë dhe, nga ana tjetër, e rriti shkallën e informimit të policisë për rastet e kultivimit të kanabisit.*

2. Intensifikimi i luftës kundër drogës nëpërmjet organizimit të operacioneve të vazhdueshme për kapjen dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të personave që konsumojnë veprën penale të kultivimit dhe të trafikimit të bimëve narkotike. Në shënjestrën e policisë ishin kryesisht ata që punonin në nxitjen, organizimin, kultivimin, përpunimin, transportin dhe trafikimin e kanabisit.

** Nëpërmjet kësaj u dha mesazhi se do të goditeshin ashpër të gjithë ata që nxitnin apo organizonin kultivimin e bimëve narkotike, si dhe ata që merreshin me grumbullimin e prodhimit të vjelë të kanabisit. Bashkë me këta, do të merrnin goditje në njëfarë mënyre edhe porositësit dhe menaxhuesit e prodhimit të kanabisit. Kjo ndikoi edhe në rënien e nivelit të blerjes së prodhimit të vjelë të kanabisit nga fshatarët (mbetjen stok të prodhimit të tyre), duke ndikuar në këtë mënyrë në humbjen e interesit për kultivimin e kanabisit nga ana e fermerëve.*

3. Dhënia e informacionit të nevojshëm për pasojat ligjore që parashikon legjislacioni shqiptar në rast kultivimi të kanabisit. Kjo do të realizohej nëpërmjet përgatitjes dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve. Në to, përveç informacionit të nevojshëm juridik, jepeshin dhe numrat e telefonit të policisë për të thithur informacion për rastet e kultivimit etj.

** Në fletëpalosjet e prodhuara enkas citoreshin nenet e Kodit Penal për dënimin e kultivimit, të mbajtjes dhe të transportit të drogave. Ato u shpërndanë nëpër shkollat, fshatrat, në çdo familje, sidomos në zonat që njiheshin për veprimtari në kultivimin e kanabisit, me qëllim që të informohej komuniteti dhe të parandalohej në kohë kultivimi masiv i bimëve narkotike.*

4. Bashkëpunimi i ngushtë me mediat lokale. Ky kishte si synim për të informuar, ndërgjegjësuar dhe për të rritur ndjeshmërinë e opinionit publik ndaj rreziqeve të drogës dhe për të kërkuar bashkëpunimin e tij në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.

** Me mediat lokale u organizuan emisione të veçanta, biseda televizive dhe spote, ku trajtoheshin pasojat e drogës, në përgjithësi, dhe ato të kultivimit të bimëve narkotike, në veçanti. Në këto emisione merrnin pjesë specialistë nga Drejtoria e Policisë së qarkut, mjekë, juristë, gazetarë etj., për t'u dhënë sa më shumë informacion banorëve lidhur me pasojat që sjell kultivimi i bimëve narkotike, për ndëshkimin ligjor për vepra të tilla penale, si edhe për të pasqyruar në vazhdimësi punën goditëse të bërë nga Drejtoria e Policisë në luftën kundër drogës etj.*

5. Përgatitja e temave mësimore që trajtojnë pasojat e drogës, rreziqet që ajo bart, dënimet që marrin shtetasit shqiptarë që shkelin ligjin duke kultivuar, përpunuar, transportuar dhe trafikuar lëndë narkotike.

** Këto tema iu vunë në dispozicion Drejtorisë Arsimore për t'i punuar me nxënës të shkollave të qarkut, sidomos në ato shkolla ku përdorimi i drogës ishte bërë shqetësues.*

6. Ndërhyrja e organizmave shtetërore me programe dhe mbështetje me kredi biznesi për banorët e zonave më problematike në kultivimin e bimëve narkotike. Puna e fermerëve të këtyre zonave do të orientohet, kështu, në veprimtari të ligjshme, për t'i shkëputur ata nga kultivimi i bimëve narkotike dhe për t'i nxitur që të mbillnin bimë të tjera bujqësore.

** Mbështetja e fermerëve me kredi biznesi për të nxitur heqjen dorë nga kultivimi i bimëve narkotike është synuar edhe më parë. Kështu, në datat 10 - 17 prill 2000, si drejtor i Policisë Kriminale në Ministrinë e Rendit Publik, në përbërje të delegacionit shqiptar, kam marrë pjesë në Kongresin e 10-të të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimin. Gjatë ditëve të Kongresit, u takuam dhe me zotin Pino Arlachi, zëvendëssekretar i Kombeve të Bashkuara dhe Drejtor Ekzekutiv i UNODCCP (Zyra për Kontrollin mbi Drogën dhe Parandalimin e Krimin) në Vjenë. Në këtë takim kemi trajtuar nevojën e gjetjes së rrugëve për uljen e kultivimit të kanabisit në Shqipëri. I kërkuam zotit Arlachi mbështetjen nga ana e tyre me programe për financimin e bizneseve në zonat ku kultivohej kanabisi në Shqipëri, me qëllim që fshatarët të hiqnin dorë nga kultivimi*

i kanabisit dhe të bëheshin të interesuar për zhvillimin e bizneseve të ndershme. Natyrisht, pati vetëm premtime, të cilat nuk u realizuan. Si përfundim, zgjidhjen e këtij problemi duhet ta gjenim vetë.

** Njëpërmjet Prefekturës u vendos një central telefonik prej 1000 numrash dhe një postë policie në komunën Cakran; u kryen investime në riparimin e shkollave; u bënë projekte për ndërtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza etj. Në këtë pikë jemi të ndërgjegjshëm se më shumë duhet të bëhej për nxitjen e biznesit të vogël, për mbështetjen e fermerëve me kredi me kushte lehtësuese, me mekanikë bujqësore, me farëra të zgjedhura etj.*

7. Përgatitja dhe shpërndarja e deklaratave tip, me anën e të cilave fermeri të deklaronte se në sipërfaqen e tokës që disponon nuk do të kultivojë bimë narkotike dhe se nuk disponon farë apo prodhime narkotike të viteve të kaluara.

** Me ndjekjen e këtij problemi u angazhuan inspektorët e policisë së rendit dhe kryepleqtë e fshatrave. Efektet e kësaj pune ishin më tepër psikologjike. Deklarata në fjalë nuk kishte vlerë ligjore, por njëpërmjet saj synohej që fermeri të merrte informacionin e duhur për pasojat që mund të ketë, nëse ai kultivon bimë narkotike.*

8. Bashkëpunimi i ngushtë me gjykatat dhe prokuroritë. Synimi ishte për të nxitur një politikë më të ashpër penale në kërkimin dhe dhënien e masave të dënimit për personat që konsumojnë vepra penale të fushës së drogave. Kjo sidomos për personat organizatorë të këtyre veprave penale, por duke mos përjashtuar kultivuesit e bimëve narkotike.

** Pra, përveç punës sqaruese dhe bindëse për moskultivimin e kanabisit, do të ngulej këmbë edhe në forcën e ligjit e të drejtësisë, njëpërmjet ndëshkimit të merituar dhe pa kompromis të autorëve të këtyre veprave penale, që do të tentonin të sfidonin ligjin. Në përgjithësi, për rastet e kultivimit të bimëve narkotike është synuar që, në bashkëpunim me prokurorinë, autorët e kësaj veprave penale të procedohen në gjendje arresti. Mjafton të përmendim rastet e fshatit Varibob, ku u proceduan në gjendje arresti dy gra kultivuese të kanabisit.*

9. Koordinimi i punës me Shërbimin Qendror të Luftës Kundër Drogës dhe me drejtoritë e vendeve fqinje.

10. Caktimi i detyrave të karakterit specifik dhe profesional në planet e masave, sipas komisariateve dhe sektorëve të Drejtorisë së Policisë së qarkut, në mbështetje dhe në zbatim të strategjisë antikanabis.

11. Krijimi i shtabit të drejtimit në Drejtorinë e Policisë së qarkut. Shtabi ishte për të ndjekur në vazhdimësi zbatimin e detyrave të planit strategjik, si dhe për të analizuar këtë problem në dinamikë, duke propozuar dhe zgjidhjet e duhura.

** Shtabi i Drejtorisë mblidhej dy herë në javë. Në të raportohej për zbatimin e detyrave të planit strategjik. Inspektorët e Policisë së Rendit nëpër zona përgatisnin çdo javë raport me shkrim, nëse ishin konstatuar raste kultivimi në zonat që ata mbulonin dhe për masat e marra. Nëse më vonë konstatohej se inspektori i policisë kishte bërë raportim fiktiv, pa e njohur gjendjen në zonë, ndaj tij merreshin masa deri në largimin nga puna.*

12. Krijimi i shtabeve në njësitë vendore. Pranë çdo komune ngrihet shtabi, i cili nën drejtimin e kryetarit të komunës dhe në bashkëpunim me drejtorët e shkollave të mesme dhe 8-vjeçare të zonës, me administratën e komunës dhe me inspektorin e policisë së rendit në zonë ndjek zbatimin e planit strategjik në shkallë komune. U synua që struktura të tilla të ngriheshin edhe në nivel fshati, nën drejtimin e kryeplakut.

**Nga strukturat e pushtetit vendor pranë çdo komune u ngritën shtabet e ndjekjes së detyrave të lëna në planin strategjik. Në këto shtabe bënin pjesë përfaqësues të administratës së këtyre komunave, të cilët përballuan një punë të madhe në zhvillimin e luftës parandaluese, duke ndërgjegjësuar banorët për të asgjësuar fidanet e mbjella në parcelat e tyre. Shtabet bashkëpunuan me strukturat e policisë së qarkut Fier, duke koordinuar ndërhyrjet dhe veprimet policore me asgjësimin vullnetar të fidaneve, që bëhej nga vetë banorët e këtyre komunave.*

Konferenca rajonale për Strategjinë

Përgjithësisht, këto ishin detyrat që u planifikuan për t'u zbatuar. Siç shihet, pjesa më e madhe e detyrave synonte **në parandalimin e mbjelljes së bimëve narkotike,** pasi është më mirë të parandalosh, sesa të dënosh.¹

Duke parandaluar mbjelljen e bimëve narkotike do të dilnin të fituar, si fermerët, ashtu edhe policia. Fermerët nuk do të harxhonin mund, djersë dhe pará

¹ C. Baccaria - "Tratatto dei delitti e delle penne", Milano 1964.

për mbjelljen dhe rritjen e bimëve narkotike, të cilat, me ndërhyrjen e policisë, do të shkonin dëm dhe, më keq akoma, ata vetë do të kishin probleme me drejtësinë. Policia, nga ana e saj, duke parandaluar kultivimin e bimëve narkotike, do të kursente mund e djersë, pasi nuk do të kishte fushata të asgjësimit të bimëve narkotike në pikun e verës. Kështu, forcat dhe energjitë e saj, policia do t'i përdorte në drejtime të tjera të luftës kundër krimit.

Për ta publikuar këtë plan strategjik dhe me synimin për ta vënë sa më shpejt atë në zbatim, më datë 07.02.2001, me nismën e Drejtorisë së Policisë së qarkut dhe me bashkëpunimin e Prefekturës së Fierit, u organizua në mjediset e Drejtorisë së Policisë Konferenca Rajonale me temë: “Parandalimi i kultivimit të bimëve narkotike në qarkun e Fierit”.

Në konferencë morën pjesë përfaqësues të pushtetit vendor, kryetarë të komunave të qarkut Fier, kryepleq, përfaqësues nga gjykatat, prokuroria etj. Pra, ishin aty të gjithë subjektet që do të punonin për zbatimin e kësaj strategjie. Po ashtu, morën pjesë përfaqësues të OSBE-së, të UNDCP-së, të komuniteteve fetare, të mediave lokale, përfaqësues të drejtorive arsimore, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët, më pas, dhanë një ndihmesë të madhe në realizimin me sukses të planit strategjik.²

Në konferencën rajonale u konkludua se rol përcaktues në suksesin e luftës kundër kultivimit masiv të bimëve narkotike *kanabis sativa* ka puna për parandalimin qysh në fazën e mbjelljes së bimëve. Gjithashtu, u konkludua se kjo nuk mund të arrihet vetëm nga strukturat e policisë, pa një mbështetje nga pushteti vendor, nga struktura të tjera të shtetit, si dhe pa bashkëpunimin me komunitetin dhe me shoqërinë civile.

Rezultatet e Strategjisë në praktikë

Zbatimi pikë për pikë i planit³ për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike në qarkun e Fierit, solli rezultate befasuese brenda disa muajve. Pas një pune intensive u arrit përfundimisht parandalimi i kultivimit masiv të tyre. U konstatuan në këtë kohë vetëm disa mbjellje sporadike në sipërfaqe tepër të vogla, kryesisht deri në 20 rrënjë (kjo më tepër për ruajtje të farës, sesa për prodhimin e marihuanës), larg qendrave të banuara në parcela pa pronësi (përrenj, buzë

² Në këtë Konferencë mori pjesë dhe ministri i Rendit Publik, i cili e vlerësoi strategjinë dhe kërkoi zbatimin e saj në shkallë kombëtare.

³ Me njoftimin për shtyp të datës 30.01.2001, Drejtoria e Policisë e qarkut Fier e bëri publik, për të gjithë komunitetin e qarkut, Strategjinë e re antikanabis dhe kërkoi bashkëpunimin e tij për ta zbatuar atë.

kanaleve dhe në kodra), të mbjella në mënyrë të çrregullt dhe që nuk u kryheshin shërbime.

Konkretisht, në vitin 2001, u evidencuan dhe u asgjësuan 3080 rrënjë bimë narkotike, një shifër kjo mjaft e ulët në krahasim me një vit më parë, kur qenë asgjësuar 51.775 bimë. Pra, rezultoi një rënie rreth 17 herë e kultivimit të kanabisit, krahasuar me vitin paraardhës. Ndërsa në rrethet Lushnjë dhe Mallakastër atë vit nuk u regjistrua asnjë rast kultivimi bimësh narkotike.

Numri i procedimeve u ul në mënyrë të ndjeshme. Këtë vit pati vetëm 17 raste, nga 77 që ishin në vitin 2000. Pra, pati një ulje të procedimeve penale për veprën e kultivimit të bimëve narkotike në masën rreth 3,5 herë. Gjithashtu, u konstatua se shumica e kultivuesve ishin të seksit femër dhe në moshë të madhe, të cilat nuk kishin në familjet e tyre meshkuj të aftë për punë dhe kishin mbetur pa të ardhura ekonomike.⁴

Arritja e këtyre rezultateve që në muajt e parë të zbatimit të strategjisë së re tregoi se, tashmë, kishim gjetur “ilaçin e duhur,, për ta luftuar sëmundjen kanabis. U krijua bindja dhe siguria se zbatimi i kësaj strategjie në vitet në vazhdim do ta çonte drejt nivelit zero kultivimin e bimëve narkotike në qarkun e Fierit.

Zbatimi i kësaj strategjie, si një formë dhe metodë e re në punën e policisë, e cila kishte në themel parandalimin e krimit në bashkëpunim me komunitetin dhe me shoqërinë civile, si dhe rezultatet e arritura gjetën mbështetjen e opinionit dhe të medias lokale e qendrore.⁵

Plani strategjik i aplikuar nga Drejtoria e Policisë së qarkut Fier, megjithëse u hartua dhe u zbatua pa ndonjë orientim të veçantë të politikës, u vlerësua nga vetë ministri i Rendit Publik dhe u urdhërua Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për ta aplikuar edhe në qarqet e tjera problematike për kultivimin e bimëve narkotike, sidomos në Vlorë dhe në Shkodër.

⁴ U evidentua si taktikë e kultivuesve të bimëve narkotike që, në rastet e kapjes nga policia, të deklaronin si pronarë të bimëve narkotike më të moshuarit e shtëpisë, me qëllim për t'i shpëtuar arrestimit.

⁵ Gazeta “Korrieri” e datës 07.09.2001, në faqen 9, i bën një analizë të hollësishme dukurisë së kanabisit në shkallë vendi dhe ndalet veçmas për strategjinë e zbatuar në Fier dhe për suksesin e zbatimit të saj. Po kështu, edhe revista “Klan”, në numrin e saj të datës 18 mars 2001, me një reportazh nga fshati Cakran tregon se ka ndjekur në vend zbatimin e strategjisë antikanabis. Gjithashtu, kjo strategji është trajtuar edhe nga të përditshmet “Shekulli”, “Gazeta shqiptare”, nga televizionet kryesore qendrore etj.

Strategjia e re antikanabis e Policisë së Fierit u pasqyrua menjëherë në revistën “Drejt”, botim i Departamentit të Informacionit pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Në faqen 48-50, të numrit të vitit 2001, jepet një informacion i hollësishëm për Konferencën Rajonale për Antidrogën, të zhvilluar në Fier, si edhe për thelbin e strategjisë së re antikanabis.

Me ndonjë ndryshim të vogël, strategjia antikanabis, që përshkruam më lart, është e aplikueshme dhe rezultative edhe në ditët e sotme. Rezultatet e arritura në luftën kundër kanabisit tregojnë se ajo metodë përbën jo vetëm formën më të mirë taktike të luftës kundër asaj dukurie, por më gjerë, edhe politikën që duhet ndjekur ndaj kanabisit. Angazhimi për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike duhet konsideruar si shprehje e vullnetit politik për ta luftuar këtë dukuri.

**Konferenca Rajonale
“Për Parandalimin e Kultivimit të Bimëve Narkotike”
Fier 7.2.2001**




Takimi antikanabis ne Koumunen Cakran



Prifti i Cakranit duke bere thirrje për mos kultivimin e kanabisit



Bimët narkotike te evidentuara sipas viteve ne qarqet Fier, Vlore e Shkodër(1998-2004)



Plani antikanabis i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier u bë publik për komunitetin nepërmjet një konferencë shtypi të Drejtorit të Policisë së Qarku me 30.1.2001, e cila gjendet në linkun: <https://youtu.be/-yy6t90Oqk4>